Kronikë

Vranë njëri-tjetrin në Kavajë me thika e pistoletë, sherri mes dy 43-vjeçarëve nisi me fjalët: Pse më sheh ashtu?

Pak minuta mjaftuan për të tensionuar situatën për shkak të një konflikti për shkaqe krejt banale disa ditë më parë, për sharje. Ditën e djeshme Altin alias Sali Rexha ka qenë në lokalin afër shtëpisë së tij me qira kur ka ardhur Armandi, i cili nuk ka lidhje me zonën pasi nuk jeton aty afër

■ Përplasje me thika dhe armë zjarri në Kavajë, 2 viktima, njëri kishte përdore fëmijën! Konflikti nisi 3 ditë më parë, sot u takuan për 'sqarim' (EMRAT)

Armand Gosa dhe Sali Rexha

Sokol Dema
30 Mars, 10:33 | **Përditesimi: 30 Mars, 11:03**

Armand Gosa (Edmond) dhe Sali Rexha, ***dy 43-vjeçarët*** që vranë njëri-tjetrin në Kavajë pasditen e së mërkurës u takuan rastësisht në lokalin ku ndodhi ngjarja e rëndë. Pak minuta mjaftuan për të tensionuar situatën për shkak të një konflikti për shkaqe krejt banale disa ditë më parë, për sharje. Ditën e djeshme Altin alias Sali Rexha ka qenë në lokalin afër shtëpisë së tij me qira kur ka ardhur Armandi, i cili nuk ka lidhje me zonën pasi nuk jeton aty afër.

Nuk dihet saktësisht nëse ardhja e Gosës pranë shtëpisë së Rexhës ka pasur synim konfliktin apo jo, por dëshmitarët e vendit të njjarjes i thanë policisë se nisja e konfliktit ishte me fjalët 'pse me sheh ashtu'. Policia ka përfunduar veprimet paraprake dhe rezulton se nuk ka persona të tjerë të përfshirë në konflikt.

[Sh].com

LEXO EDHE:
Tokat e tyre preken nga ndërtimi i aksit Thumanë-Kashar, banorët e Bërxullës sërish në protesë: Do i mbrojmë pronat me gjak

Të dy viktimat rezultojnë me precedent të mëparshëm penal, Gosa për vrasjen e Genti Gjuzit disa vite më parë pasi e goditi me kazëm në sherrin që nisi për një vajzë, ndërsa Rexha ka të regjistruar një procedim për një sherr që ka ndodhur më herët. Të dy rezultojnë me emra të ndryshuar dhe dyshimet e bluve janë se e kanë bërë për shkak të problemeve që mund të kenë pasur jashtë vendit.

Vrasja e dyfishtë u regjistrua pasditen e të mërkurës (29 Mars) në një lokal në Kavarë në qendër të qytetit. Ka qenë Gosa që ka plagosur fillimisht me thikë Rexhën dhe më pas ky i fundit i është kundërpërgjigjur me armë. Altin Rexha i cili ka ndryshuar emrin në Sali Rexha, ka qenë me një fëmijë përdore në momentin e konfliktit. Gjithashtu edhe Edmond Gosa e ka ndryshuar emrin në Armand Gosa, teksa fisi i tij mbahet si "të fortët" në Kavajë. Ky i fundit, njihet si person problematik në qytet, i dënuar më parë për plagosjen e rëndë të Gent Gjuzit me kazëm, i cili vdiq më pas në spital.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: vrasje | Edmond Gosa | Altin Rexha | kavaje | Tirane

Komento

Komente

Italiani: 30/03/2023 11:02

Shum mire, ne qoft se eshte keshtu dy plera me pak.

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Mendoni se arrihet objektivi i qeverisë për pagë mesatare 900 euro?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Beteja e Tiranës dhe diferencat e thella midis palëve

Plator Nesturi

30 Mars, 08:52

Sherr mes të rinjve në Tiranë, plagoset me thikë 19-vjeçari te 'Komuna e Parisit'! Arrestohet autori

29 Mars, 21:52



FOTOT/ Vranë njëri-tjetrin pas konfliktit për motive të dobëta, këta janë dy viktimat e ngjarjes së sotme në Kavajë

29 Mars, 21:09

U konfliktuan brenda në lokal më pas vranë njëri-tjetrin me armë, zbardhen emrat e dy viktimave në Kavajë

29 Mars, 19:29

Përplasje me thika dhe armë zjarri në Kavajë, 2 viktima, njëri kishte përdore fëmijën! Konflikti nisi 3 ditë më parë, sot u takuan për 'sqarim' (EMRAT)

29 Mars, 19:21

'Agjenda 2030' e miratuar nga OKB/ Shqipëria, pionere e Objektivave të Zhvillimit të Brendshëm, nisma mbështetet dhe nga violinisti i njohur Olen Çezari

Ledina Jakimi

29 Mars, 18:51

FOTOT/ Kush janë pronarët e faqeve 'Jeta Osh Qef' e Lolita! Veliaj: Erland Dalliu dhe Anisa Caka gjoba autobusëve të Tiranës, do të paditen në prokurori

29 Mars, 17:14

Goditi me grusht efektivin, Gjykata liron nga paraburgimi 22-vjeçarin në Tiranë

29 Mars, 16:00

Aksidentet e autobusëve? Veliaj: Nga 7 rastet e fundit, në 5 të tilla shkak janë bërë makinat, në dy raste drejtuesit kishin probleme shëndetësore

29 Mars, 14:31

Misteri i pasurisë së Këlliçit, BMW luksoze, pemëtore e 90 mijë USD me rrogë modeste! Mungojnë të dhënat për bashkëjetuesen! Gënjeu për vlerën e makinës?

Adriatik Doci

29 Mars, 13:17

Pjesë e grupit kriminal që dërgonin emigrantët me viza false për 10 mijë euro në SHBA e Britani, arrestohet 54-vjeçari në Tiranë! I dënuar nga GJKKO me 7 vite burg

29 Mars, 13:14

VIDEO/ I dënuar për prodhim e shpërndarje të materialeve pornografike në Gjermani, pranga të riut të huaj që fshihej në Tiranë

29 Mars, 12:23

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje